

**AKTI I THEMELIMIT  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“MANE DEVELOPMENT” SH.P.K.**

Sot më datë, 14.09.2022, pala e mëposhtme,

- **Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k.**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, me seli në Njesia bashkiake nr.2, Rruga “Papa Gjon Pali II”, Ndertesa Nr.12, Kati 11, Zyra nr.1206, Kodi Postar 1010, Tiranë, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS: K72223031K, përfaqësuar nga administratori Znj. Edlira Muka, shtetase shqiptare, lindur më 03.02.1983, në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 034271384, ne përputhje me Vendimin e Ortakut të Vetëm të datës 14.09.2022.

në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, dhe legjisllacionit të zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë, nëpërmjet nënshkrimit të këtij Akti Themelimi ka vendosur të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të emëruar “**MANE DEVELOPMENT**” Sh.p.k.. Aktiviteti i kësaj shoqërie do të kryhet në përputhje me legjisllacionin shqiptar në fuqi, Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj bashkëlidhur këtij akti si Shtojca A, i cili konsiderohet pjesë thelbësore e Aktit të Themelimit.

**Neni 1 – Emërtimi i Shoqërisë**

- 1.1 Është themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e quajtur “**MANE DEVELOPMENT**” Sh.p.k. (këtej e tutje referuar edhe si “**Shoqëria**”).
- 1.2 Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

**Neni 2 - Selia**

- 2.1 Selia e Shoqërisë është në **Rruga: “Tish Daija”, Kompleksi Kika 2, Godina 3, kati 1, Tiranë, Shqipëri.**
- 2.2 Asambleja e Përgjithshme mund të hapë dhe/apo mbyllë degë dhe/ose zyra përfaqësimi, në Shqipëri apo jashtë saj. Ndërsa Administratori i Shoqërisë mund të çelë, transferojë dhe/apo mbyllë seli sekondare dhe/ose agjenci në Shqipëri.

**Neni 3 - Kohëzgjatja**

- 3.1. Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje të pakufizuar.
- 3.2. Shoqëria mund të prishet në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

**Neni 4 – Objekti**

- 4.1 Shoqëria ka për objekt parësor veprimtarie kryerjen e aktiviteteve të listuara më poshtë:

- investimi në blerjen, ose përfitimin e të drejtave për zhvillimin e pasurive të paluajtshme, si dhe ushtrimi i të gjitha aktiviteteve që kanë të bëjnë me ose plotësojnë, direkt apo indirekt, aktivitetin e mësipërm;
  - të bashkëpunojë dhe/ose të përfitojë, direkt apo indirekt, pjesëmarrje në shoqëri, ndërmarrje, agjenci dhe sipërmarrje të tjera, të cilat mund të kenë një objekt aktiviteti të ngjashëm.
- 4.2 Gjithashtu, për të realizuar objektin e saj, Shoqëria mund të kryejë çdo lloj transaksioni lidhur me shitblerjen e pasurive të luajtshme e të paluajtshme, si edhe çdo aktivitet tregtar, financiar, qiraje apo hipotekimi që i vlerëson të dobishme apo të nevojshme për arritjen e qëllimeve të saj me kusht që aktivitetet e mësipërme të mos jenë në kundërshtim me objektin e Shoqërisë.

#### **Neni 5 – Kapitali themeltar**

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 1,000 LEK (një mijë lekë), i përbërë nga 1 (një) kuotë me një vlerë nominale prej 1,000 LEK (një mijë lekë).
- 5.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë është nënshkruar dhe paguar plotësisht si në vijim:
- **Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k.**, ka kontribuar në para për kapitalin e Shoqërisë në shumën prej 1,000 LEK (një mijë lekë).
- 5.3 Duke u bazuar në kontributet e mësipërme:
- **Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k.**, zotëron 1 (një) kuotë, e barabartë me 100% (një qind përqind) të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

#### **Neni 6 – Transferimi i Kuotave**

Kuotat e Shoqërisë mund të transferohen, tërësisht apo pjesërisht, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 8 të Statutit.

#### **Neni 7 – Administratori/ët**

- 7.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë Administratorë. Në rast se ka më shumë se një Administrator, Administratorët do të veprojnë bashkërisht përveçse kur parashikohet ndryshe në aktin e emërimit të tyre. Administratorët do të qëndrojnë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 5 (pesë) vjeçare, me mundësi rizgjedhje. Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr vendim përpara mbarimit të afatit në detyrë, mandati i tyre do të rinovohet automatikisht edhe për një vit tjetër.
- 7.2 Administratori/ët përfaqëson ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron të gjitha fuqitë e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme.
- 7.3 Administratori/ët mund të emërojë përfaqësues me prokurë speciale ("*ad negotia*") për kryerjen e një akti ose kategori aktesh në kufijtë e tagrave që u janë dhënë atyre.
- 7.4 Personi i mëposhtëm caktohet si Administratori i parë i Shoqërisë:

- Z. Erion Avram, shtetas shqiptar, lindur më 12.06.1978, në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 036824270, dhe me numër personal H80612140L.

#### Neni 8 – Dispozita të Fundit

- 8.1 Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt Themelimi, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar.

\*\*\*

**NË DËSHMI TË SA MË SIPËR**, Pala deklaron se ky Akti Themelimi dhe Statuti bashkangjitur si Shtojca A, është në përputhje me vullnetin e saj dhe për këtë arsye e nënshkruan atë në datën e sipërhënuar, me vullnet të plotë dhe të lirë.

**Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k,**



Përfaqësuar sipas Vendimit të Ortakut të Vetëm nga:

**Znj. Edlira Muka**



